



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:209727
Datë: 29.08.2024
Numri i dokumentit: 06102453

KPPP.nr.1580/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbare të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” Sh.A., në Prishtinë, rr. “Hazir Shala” Nr.4, kundër debitorit IP-KOS Sh.P.K., me adresë Rr.Fsh Shkabaj-Mitrovicë-Prishtinë, me NUI: 810834673, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbare P.nr.504/23 të datës 24.08.2023 të Përmbareusit Privat Arsim Bajraktari me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.08.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit IP-KOS Sh.P.K., me adresë Rr.Fsh Shkabaj-Mitrovicë-Prishtinë, ANULOHET Urdhri Përmbare P.nr.504/23 i datës 24.08.2023, i Përmbareusit Privat Arsim Bajraktari dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbaremi në këtë çështje përmbare.

A r s y e t i m

Përmbareusi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” Sh.A., ka caktuar urdhrin përmbare P.nr.504/23 të datës 24.08.2023, me të cilin ka lejuar përmbaremin në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstraktit nga Librat Afariste 1433 të lëshuar nga kreditori, me të cilin është detyruar debitori që në emër të përmbareshjes së obligimeve të papaguara për periudhën kohore prej datës 31.12.2022 deri me

datë 31.08.2023, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin t'ia paguajë kreditorit shumën prej 730.32 €, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor, me arsyetimin se dokumenti në bazë të të cilit është marr urdhri nuk është dokument i besueshëm për përmbarim në bazë të LPP-së. Më tutje ka theksuar se borxhi për të cilin është lëshuar urdhri përmbarimor nuk është borxh i IP KOS Sh.P.K., për shkak se kompania ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale qiramarrje me qiradhënësin objektit për të cilin kërkohet shlyerja e borxhit nga data 01.08.2023. Ka shtuar se vlera e riprogramuar e borxhit paraprak sipas pasqyrës financiare është 767.54 Euro borxh ky i cili edhe është bartur në emër të IP KOS Sh.P.K., por nuk është shfrytëzuar nga e njëjta. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri për përmbarim i Përmbaruesit Privat, si dhe të obligohet kreditori që t'i bartë shpenzimet përmbarimore në tërësi.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pabazuar, të pa argumentuar si dhe pa bazë ligjore dhe pa mbështetje në prova. Më tutje ka theksuar se parashkrimi ndërpritet ku debitori e pranon borxhin, dhe pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa dhënia e sigurimit. Ka shtuar se debitori me datë 21.09.2022 ka ushtruar kërkesë për riprogramimin e borxhit ku ka bërë pagesë në vlerë prej 767.54 Euro dhe pjesën e mbetur debitori ka pranuar që të bëjë pagesën me këste mujore. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar dhe i pa argumentuar, të obligohet debitori që të kryej obligimin ndaj kreditorit, si dhe me rastin e ankesës t'i caktojë debitorit shumën e garancionit deri në vlerën e propozimit sipas nenit 77 par.5 dhe nenit 78 par.1/2 të LPP-së.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit si dhe shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet dhe procedura përmbarimore të përfundojë në tërësi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm - Ekstrakti nga Librat Afariste me shifrën 1433 i lëshuar nga kreditori, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Në rastin konkret pavarësisht faktit se propozimi për përmbarim është lejuar sipas Ekstrakti nga Librat Afariste me shifrën 1433 në kuadër të Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” Sh.A., gjykata gjeti se dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin, nuk i plotëson kushtet që të konsiderohet dokument i besueshëm për shkak që nuk i përmban tiparet e një ekstrakti nga librat afarist, meqenëse në këtë dokument nuk evidentohet saktësisht periudha kohore për të cilën kërkohet përmbushja e detyrimit.

Nga ekstrakti afarist i bashkëngjitur sipas shifrës 1433, figuron periudha kohore prej datës 31.12.2013 ku edhe borxhi fillestar rezulton të jetë 27,597.01 €, deri tek data 31.08.2023 ku vlera e borxhit është 730.32 €, ndërsa në përmbajtjen e këtij ekstrakti, nuk është përfshirë fare periudha prej datës 01.01.2013 deri me datën 30.12.2013, me ç’ rast nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhë kohore është grumbulluar borxhi në fjalë.

Meqenëse dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbarimor, përkatësisht Ekstrakti nga Librat Afariste me shifrën 1433, nuk është dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, gjykata nuk i shqyrtoi fare pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim dhe duke u bazuar në nenin 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenin 12 par.2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e

Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, si dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1580/23 datë 28.08.2024

Gjyqtari
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.